



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 119, Datë 07 / 05 / 2018

Mbështetur në ligjin nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr.134 Regj., datë 20.10.2017¹, e znj.M. K, e cila pretendon diskriminim nga ana e drejtueses së Zyrës Arsimore Mat dhe drejtuesi i Shkollës së Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata”, Suç², për shkak “të gjendjes së saj shëndetësore” dhe “të bindjeve politike³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesja M. K ka ushtruar profesionin e mësueses në profilin biologji-kimi në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata” Suç⁴ për 25 vite. Drejtori i SHMB Suç, me shkurtimin e një klase të X-të në Arsimin e Mesëm të Lartë⁵, me shkresën nr.104 prot., datë 18.09.2017 i ka kërkuar ZA Mat të bëjë vlerësimin e dosjeve të mësuesve të profilit biologji-kimi dhe gjuhë-letërsi për të përcaktuar kështu mësuesin që mbetet pa ngarkesë mësimore lëndore. Me datë 21.09.2017 ankueses i është komunikuar shkresa me nr.414 prot., datë 20.09.2017 e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve, drejtuar Drejtorisë së SHMB-së Suç. Sipas kësaj shkrese, titulluar “Dërgohen pikët e vlerësimit të dosjes së kandidatëve që kanë mungesë të ngarkesës mësimore në lëndët gjuhë shqipe dhe letërsi dhe biologji-kimi, në SHMB Suç”, rezulton se në lëndën biologji-kimi ankuesja është vlerësuar me 37.9 pikë, ndërsa dy mësues të tjerë (SH.K, A.S) janë vlerësuar respektivisht me 44 dhe 40.2 pikë. Ankuesja ka ankimuar vlerësimin e këtij komisioni, pranë ZA Mat dhe pranë Ministrisë së Arsimit, duke pretenduar se akti është në kundërshtim me ligjin, pasi vlerësimi i dosjes është bërë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

Me vendimin nr.19, datë 12/10/2017 të ZA Mat i është komunikuar lëvizja paralele e detyrueshme nga SHMB “Haxhi Lata” Suç, në shkollën 9 vjeçare Gurrë e Madhe me detyrë mësuese ndihmëse. Kundër vendimit znj.K ka ushtruar Rekurs Administrativ në MAS Tiranë por nuk ka marrë përgjigje. Në këto kushte i është drejtuar gjykatës me padi për marrjen e masës së

¹ Plotësuar dokumentacioni nga ankuesja me datë 06.11.2017.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën SHMB Suç.

³ Ky shkak është shtuar nga ankuesi si shkak i ri gjatë sancës dëgjimore të datës 06.02.2018.

⁴ Referuar në vijim si SHMB Suç.

⁵ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën AML.

sigurimit të padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr.19 datë 12.10.2017⁶. Megjithëse ankuesja, znj.M. K ka vënë në ekzekutim nëpërmjet përmbartimit vendimin nr.306, datë 20.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Mat, ZA Mat e Drejtoria e SHMB Suç nuk e kanë rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, në zbatim të vendimit gjyqësor. Në këto kushte i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e SHMB Suç për ta zënë me punë si mësuese biologji-kimie në SHMB Suç. Ankuesja shprehet se SHMB Suç me t'u vënë në dijeni të regjistrimit të padisë në gjykatë ka marrë vendim për lirim nga detyra të saj. (Me vendimin nr. 03 datë 09.01.2018 Drejtoria e SHMB Suç ka vendosur ndërprerjen e marrdhënieve të punës me znj.K, si mësuese Biologji-Kimie në SHMB Suç). ZA Mat në zbatim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor ka marrë vendim për pezullimin e vendimit të transferimit⁷. Znj.K citon se Drejtoria e SHMB Suç në cilësinë e punëdhënësit nuk ka marrë vendim për ndërprerjen e marrdhënieve të punës me të deri me datë 06.12.2017⁸. Akti i largimit të mësuesit për shkak të ngarkesës mësimore lëndore në shkollë nxirret nga Drejtuesi i shkollës .

Rezulton që vendimi për shkurtimin e një mësuesi të profilit biologji-kimi e gjuhë-letërsi në SHMB Suç është marrë nga ish drejtori z. Gj. Lidhur me sa shprehet ankuesja se: *“Z.Gj i komanduar në cilësinë e Drejtorit të shkollës MB Suç deri në përfundim të procedurave të konkurimit, nuk ka pasur atributet e drejtorit për pasojë, dhe asnjë kompetencë që të bëjë emërim, shkurtime, të punësojë apo të shkurtojë nga puna mësues, deri sa në këtë shkollë të emërohej një drejtor nëpërmjet procedurave të konkurimit, kështu që çdo akt apo vendim i marrë nga ana e tij, në cilësinë e titullarit të institucionit është marrë në kundërshtim me ligjin dhe si të tillë është akt absolutisht i pavlefshme dhe nul dhe nuk krijon asnjë pasojë”*, këto janë pretendime që ajo i ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor.

Znj.K ka bërë gjithashtu objekt të shqyrtimit të saj gjyqësor edhe pretendimin se vendimi për lirim nga detyra i marrë nga z.U. D me date 09.01.2018, në cilësinë e titullarit të institucionit është një akt i paligjshëm dhe i nxjerrë në kapërcim të kompetencave të tij, pasi z.U. D nuk ka pasur cilësinë e Drejtorit në këtë kohë.

Znj.K shprehet se veprimet e kryera nga ana e punëdhënësit i kanë cënuar të drejtën për barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë para tij, se është diskriminuar duke i mohuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe të drejtën e pages. Ajo citon se në SHMB Suç ka mësues pa arsim të lartë dhe pa licensën e mësuesit dhe jashtë profilit, ndërkohë që asaj nuk i është ofruar ngarkesë

⁶ Me vendimin nr .306 akti datë 20/11/2017 të Gjykatës së Rrethit Mat është vendosur Marrja e masës provizore duke urdhëruar pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 19 datë 12/10/2017 të Zyrës Arsimore Mat për lëvizje paralele të detyrueshme në punë të paditëses M K , deri në zgjidhjen e çështjes.

Me vendimin nr. 267 datë 06/12/2017 të Gjykatës së Rrethit Mat është vendosur :

“Pranimi i padisë së paditëses M. K .

Shfuqizimin e vendimit nr. 19 datë 12/10/2017 të ZA Mat ,për lëvizje paralele të detyrueshme në punë të paditëses si një akt absolutisht i pavlefshëm .

Lënien në fuqi te masës provizore të marrë me datë 20/11/2017 të Gjykatës se Rrethit Mat për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 19 datë 12/10/2017 të ZA Mat ,për lëvizje paralele të detyrueshme në punë të paditëses , deri në zgjidhjen e çështjes . Vendimi i Gjykatës së Rrethit Mat nuk është ekzekutuar në mënyre vullnetare nga palët e paditura ZA Mat dhe D.SH.M.B . Suç , nga ana e palës paditëse është kërkuar ekzekutimi i vendimit gjyqësor nëpërmjet përmbartimit gjyqësor .”

⁷ Me vendimin nr. 1 datë 12.01.2018 ZA Mat ka vendosur të pezullojë vendimin nr .19 datë 12/10/2017 “Për lëvizje paralele të detyrueshme në punë deri në zgjidhjen e çështjes .

⁸ Datë në të cilën gjykata është shprehur me vendimin nr. 267, ku është vendosur shfuqizimin e vendimit të transferimit si një akt absolutisht i pavlefshëm, vendime të cilat nuk janë ankimuar nga ana e palës së paditur DSHMB Suç.

mësimore, megjithëse ka qenë mësuese me emërim të përhershëm në SHMB Suç, me titullin “mjeshtër” dhe me 25 vite punë.

Vendimmarrja e marrë nga Drejtori i shkollës nuk është marrë për shkaqe të justifikuara, por për shkak të bindjeve të saj politike dhe për shkak të gjendjes së saj shëndetësore⁹. Në vijim të pretendimeve të saj, znj.K parashtron se: *“Megjithëse të gjitha vendimmarrjet e SHMB Suç janë shfuqizuar nga gjykata, përsëri nga ana e Drejtorisë së shkollës dhe ZA Mat nxirren akte e merren vendime për të përligjur largimin tim nga shkolla Suç. Unë jam trajtuar ndryshe nga ana e Drejtorit dhe ZA, në procedurën e transferimit dhe largimit nga puna, kjo për shkak të gjendjes shëndetësore, që unë të mos kem mundësi për t’a ushtruar profesionin dhe për t’a lënë punën dhe për shkak të bindjeve politike pasi jam Sekretare e LDG Dega Mat dhe anëtare e keshillit Bashkiak Klos, Bashkia Klos si përfaqesuese e subjektit politik Partia e Bashkimit Demokrat”*.

Ankuesja pretendon se largimi saj nga puna ka ardhur dhe për shkak të ankimeve në gjykatë dhe tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndaj ZA dhe Drejtorisë së shkollës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së saj, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin e saj nga ana e ZA Mat dhe e Drejtuesit të SHMB Suç, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe të bindjeve politike, si dhe të rikthehet në vendin e saj të punës, si mësuese e lëndës biologji-kimi në SHMB Suç.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkaqet e pretenduara prej saj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka kërkuar ankueses të paraqesë dokumentet provues për pretendimin e saj¹⁰, (lidhur me shkaqet e pretenduara), meqenëse ankuesja nuk i ka bashkëngjitur ankesës dokumentet shkresore që t’i provojë ato dhe as ka parashtruar argumentime lidhur me këtë fakt. Përsa më lart, ankuesja me datë 06.11.2017 ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

Neni 91, pika 3 e Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, parashikon se: *“Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”*.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen*

⁹ Ankuesja ka depozituar një raport KMCAP-je ku cilësohet me aftësi të kufizuar.

¹⁰ Referuar procesverbalit të datës 27.10.2017, mbajtur në Zyrën e KMD-së.

shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së¹¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Shkaqet e pretenduara nga ankuesja përbëjnë shkaqe të mbrojtura nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

1. Me shkresën me nr.975/1 prot., datë 21.11.2017 i është kërkuar informacion Zyrës Arsimore (ZA) Mat, lidhur me pretendimin e znj.K¹².
- Me shkresën me nr.655 prot., datë 18.12.2017 ZA Mat ka dërguar pranë Zyrës së KMD-së parashtrimet e veta lidhur me pretendimin e subjektit ankues, të pa shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së znj.K, Komisioneri me datë 06.02.2018 realizoi një seancë dëgjimore mes palëve¹³.

¹¹ Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

- ¹² Një kopje të dosjes personale të znj.K
- Kopje të dosjes personale të mësueses Shqipe Kola. (Për efekt krahasimi me ankuesen)
- Kopje të diplomave të znj.K si dhe informacion dhe shpjegime (baza ligjore e përdorur) lidhur me konvertimin dhe përllogaritjen e pikëve të znj. K, referuar diplomës së saj të studimeve të larta. (Subjekti ankues pretendon se mësuesja Shqipe Kola nuk ka diplomë të ciklit I, II dhe DIND).
- Shpjegime dhe argumentim ligjor (baza ligjore e përdorur) si është bërë njohja dhe konvertimi i kësaj diplome?
- Informacion dhe dokumentacion provues se sa pikë kanë znj.K dhe znj.K nga vlerësimi i arritur në testimin e mësuesve në sistem.
- Informacion lidhur me pretendimin e znj.Kuka për mosllogaritjen e 5 pikëve si drejtuese shkolle, nga ana e Komisionit të Vlerësimit, referuar pikës 1, të shtojcës nr.3/1 të Udhëzimit nr.38/2015.
- Kopje të procedurës së largimit dhe të emërimit të ri të znj.Kuka.
- Kopje të kontratës aktuale të punës së Znj.K.
- Kopje të kontratës së mëparshme të znj.K.
- A jeni në dijeni të gjendjes shëndetësore të znj.K? A ka të depozituar pranë institucionit tuaj dokument (raport-mjekësor) ku provohet gjendja shëndetësore e subjektit ankues.
- Nëse po, një kopje të dokumentit provues.
- A ka kërkuar transferim znj.K për efekt të mbetjes pa ngarkesë mësimore?
- Nëse po, një kopje të kërkesës.
- A është mbajtur parasysh gjendja shëndetësore e ankueses lidhur me emërimin e fundit të saj?
- Sa është distanca në km nga qendra e vendbanimit të znj.K në shkollën ku ajo është emëruar?
- Informacion lidhur me faktin se a është e trajnuar znj.K për të punuar si mësuese ndihmëse me fëmijë me PAK?
- Nëse po, dhe kopje të dokumentacionit provues.

Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

¹³Në zbatim të Njoftimit me nr.178 prot., datë 31.01.2018, të Komisionerit.

- Në seancë ishin të pranishëm përfaqësues nga të dyja palët: ZA Mat¹⁴, SHMB Suç¹⁵ dhe subjekti ankues¹⁶.

ZA Mat dhe drejtori i SHMB Suç sollën një pjesë të dokumentacionit të kërkuar paraprakisht nga Komisioneri¹⁷. Përfaqësuesi i subjektit ankues parashtroi të njëjtat pretendime që i ka bërë prezent dhe në ankesën e znj.K si dhe shtoi si shkak të ri të diskriminimit, përveç gjendjes shëndetësore edhe bindjet politike të saj, pasi ajo është sekretare e Forumit të Partisë Demokratike, ndërsa drejtuesja e ZA Mat dhe drejtori i SHMB Suç kanë bindje të majta politike, si anëtarë të subjektit politik Partia Socialiste.

Në parashtrimet e tij ai thekson se vlerësimi i dosjeve është i padrejtë dhe i pasaktë, për faktin se znj.K ishte e emëruar si mësuese definitive pranë kësaj shkolle dhe nuk kishte se përse t'i nënshtrohej konkurimit, si dhe vetë vlerësimi i dosjeve i realizuar nga Komisioni i Vlerësimit pranë ZA Mat është i padrejtë dhe tendencioz. Ai thekson gjithashtu se transferimi i znj.K në shkollën "Gurrë" është i padrejtë pasi ajo nga mësuese e lëndës "biologji-kimi" u emërua mësuese mbështetëse.

ZA Mat dhe SHMB Suç parashtruan se në fillim të vitit shkollor ka patur rënie të numrit të nxënësve dhe si rezultat i kësaj është shkurtuar një klasë. Ata theksuan se kanë njoftuar znj.K paraprakisht përpara shqyrtimit të dosjeve nga ana e Komisionit të Vlerësimit. Meqenëse ajo mbeti pa ngarkesë mësimore dhe me qëllimin për ta sistemuar brenda sistemit, znj.R shprehet se znj.K është emëruar mësuese mbështetëse pranë shkollës "Gurrë", gjë të cilën ajo e ka refuzuar dhe po e ndjek gjyqësisht. Znj.R u shpreh se kjo ishte një lëvizje e detyrueshme paralele, me qëllim për të ndihmuar ankuesen të sistemohej në punë.

Lidhur me shkaqet e pretenduara të ankueses, drejtuesja e ZA Mat u shpreh se nuk merret fare me bindjet politike të punonjësve. Ajo shprehet se dhe z.D që është i pranishëm në seancë, në tagrin e drejtuesit të SHMB Suç ka bindje të djathta politike dhe nuk ka lëvizur nga detyra (si mësues), përkundrazi është drejtues i kësaj shkolle.

Nga ana tjetër, vetë z.D u shpreh se ai është anëtar i subjektit politik Partia Republikane, ka qenë numëruar në procesin zgjedhor si përfaqësues i i subjekteve me bindje të djathta, por ky fakt nuk ka ndikuar fare në emërimin aktual.

Në përfundim u la si detyrë për palët të sillnin dokumentacion provues lidhur me pretendimet e reja që u ngritën gjatë seancës.

3. Në vijim të dokumentacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore, me shkresën nr.236 prot., datë 09.02.2018 Komisioneri i kërkoi subjektit ankues të depozitonte në cilësi prove, dokumentacionin provues për bindjet e pretenduara politike të saj. (shtuar si shkak i ri gjatë seancës).

¹⁴ Përfaqësuar nga drejtoresha, znj.Arjana Rami.

¹⁵ Përfaqësuar nga drejtori, z.Urim Doçi.

¹⁶ Përfaqësuar nga bashkëshorti z.Verë Kuka (me autorizim të ankueses).

¹⁷ Dokumentacioni provues ndodhet në dosjen e subjektit ankues.

- Po ashtu, me shkresën nr.236/1 prot., datë 09.02.2018 Komisioneri i ka kërkuar ZA Mat të depozitohet pranë KMD-së dokumentacionin cituar në procesverbalin e seancës dëgjimore¹⁸.
- Me shkresat nr.148/1 prot., datë 15.02.2018 dhe me nr.301 prot¹⁹, datë 26.02.2018 ZA Mat dhe subjekti ankues kanë depozituar pranë KMD-së dokumentacionin e kërkuar.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe nuk është shprehur për ato pretendime që ankuesja i ka bërë njëherësh edhe objekt të shqyrtimit gjyqësor, duke vlerësuar se janë gjë e gjykuar.

A. Lidhur me pretendimin e ankueses se është trajtuar në mënyrë të disfavorshme nga ana e ZA Mat dhe SHMB Suç në procedurën e vlerësimit të dosjeve, transferimit të saj dhe largimit përfundimtar nga puna.

Subjekti ankues, znj.M. K prej 25 vitesh ushtron profesionin e mësueses në profilin biologji-kimi në SHMB Suç, me emërim të përhershëm dhe mban titullin mjeshër. Me vendimin nr.19, datë 12/10/2017 të ZA Mat i është komunikuar lëvizja paralele e detyrueshme nga SHMB “Haxhi Lata” Suç, në shkollën 9-vjeçare Gurrë e Madhe me detyrë mësuese ndihmëse. Pas shterimit të rekursit administrativ, ankuesja ka ndjekur rrugën gjyqësore për kundërshtimin e këtij akti administrativ. Me vendimin nr.306 akti, datë 20.11.2017 Gjykata e Rrethit Mat ka vendosur marrjen e masës provizore duke urdhëruar pezullimin e zbatimit të vendimit nr.19 datë12.10.2017 të Zyrës Arsimore Mat për lëvizje paralele të detyrueshme në punë të paditëses Miranda Kuka, deri në zgjidhjen e çështjes. Meqenëse vendimi gjyqësor nuk është ekzekutuar nga ana e punëdhënësit, ankuesja i është drejtuar rishtaz gjykatës me kërkesë padi. Pasi është vënë në dijeni të regjistrimit të padisë në gjykatë, SHMB Suç vendimin nr.03 datë 09.01.2018 ka vendosur lirimin nga detyra të znj.M. K. (referuar kronologjisë së fakteve)

Pas analizimit të fakteve dhe dokumentacionit të sjellë nga palët, Komisioneri konstaton se:

1. ¹⁸¹⁸¹⁸ ZA Mat të vejë në dispozicion të Komisionerit kopje të dosjeve personale për tri kandidatet e lëndës biologji-kimi të SHMB Suç, të shqyrtuara nga Komisioni i Vlerësimit të ZA Mat, përfshirë edhe dosjen e ankueses. (znj.Shqipe Kola, znj.Afërdita Suçi dhe znj.Miranda Kuka).
2. Kopje të procesverbaleve dhe procedurës së vlerësimit të mbajtura nga ana e Komisionit, si dhe vendimet përfundimtare për secilën kandidat, lidhur me mënyrën si është dalë në konkluzionet përfundimtare.
3. Kopje të dosjes personale të znj.Qefserë Sadikaj, si dhe procedura e emërimit të saj pranë SHMB Suç. Argumentimi Juaj lidhur me pretendimin e ankueses se znj.Sadikaj është favorizuar duke u mbajtur në punë pa diplomën përkatëse, vetëm se është motra e Shefit të Burimeve Njerëzore, pranë ZA Mat, z.Sadikaj.
4. Kopje të dosjes personale të z.Klenard Bala, si dhe procedura e emërimit të tij pranë SHMB Suç.
5. Informacion sa mësues që japin lëndën biologji-kimi janë të emëruar aktualisht pranë SHMB Suç, si dhe sa orë mësimore është norma dhe ngarkesa për këto mësues? Sa orë realizojnë aktualisht ata?
6. Argumentimet Tuaja (ZA Mat) lidhur me pretendimin e ankueses se është diskriminuar edhe për shkak të bindjeve politike, shkak që u pretendua gjatë seancës dhe jo deri në këtë moment të shqyrtimit të ankesës pranë Komisionerit.

¹⁹ Nr.prot,i KMD-së.

Drejtori i SHMB Suç, me shkurtimin e një klase të X-të në AML, me shkresën nr.104 prot., datë 18.09.2017 i ka kërkuar ZA Mat të bëjë vlerësimin e dosjeve të mësuesve të profilit biologji-kimi dhe gjuhë-letërsi për të përcaktuar kështu mësuesin që mbetet pa ngarkesë mësimore lëndore. Me kërkesën e drejtorit të SHMB Suç ZA Mat ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve për vlerësimin e dosjeve.

Me shkresën nr.414 prot., datë 20.09.2017 të ZA Mat, SHMB Suç është njohur me rezultatin përfundimtar të vlerësimit të dosjeve, nga ku ka rezultuar se për mësueset e profilit biologji-kimi:

- SH.K është vlerësuar me 44 (dyzet e katër)pikë
- A.S është vlerësuar me 42 (dyzet e dy)pikë
- M. K është vlerësuar me 37.9 (tridhjetë e shtatë. nëntë)pikë.

Theksojmë se rezultatin e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve pranë ZA Mat, ankuesja e ka kundërshtuar si administrativisht, ashtu dhe gjyqësisht, dhe duke qenë gjë e gjykuar, për këtë arsye Komisioneri nuk do të shprehet lidhur me këtë pikë por do të vlerësojë procedurën e ndjekur nga ky komision dhe ZA Mat (në tagrin e titullarit të institucionit në varësi të të cilit është dhe Komisioni për Vlerësimin e Dosjeve) në përputhje me ligjshmërinë e tij dhe parimin e trajtimit të barabartë mes konkurrentëve.

Në vijim të sa mësipër, rezulton se:

Drejtori i SHMB Suç pasi është njohur me vlerësimin e Komisionit të ZA Mat ka bërë shpërndarjen e ngarkesës mësimore të dy mësuesve të renditur të parët dhe ka hequr ngarkesën e plotë mësimore për znj.K duke e lënë atë me ngarkesë mësimore lëndore 6 orë mësimi në javë. Me vendimin nr.19, datë 12.10.2017 të ZA Mat i është komunikuar lëvizja paralele e detyrueshme në punë, duke e emëruar me detyrë mësuese ndihmëse në shkollën 9-vjeçare “Gurrë e Madhe”. Nga ana e Drejtorisë së shkollës Suç i është komunikuar verbalisht vendimi i transferimit të ZA Mat për në shkollën 9-vjeçare Gurrë e Madhe dhe për shkak të emërimit në një pozicion tjetër i është hequr ngarkesa mësimore lëndore si mësuese biologji-kimie në SHMB Suç. Theksojmë se, nuk rezulton të ketë një vendimmarrje të SHMB Suç për shkurtimin nga puna si mësuese biologji-kimie në SHMB Suç të znj.M. K, as me datë 13.09.2017 kur kanë filluar procedurat e shkurtimit të një mësuesi të kësaj lënde,as me datë 21.09.2017, kur i është komunikuar vendimi i komisionit të vlerësimit të dosjeve, dhe as me datë 12.10.2017 kur është marrë vendimi për emërim si mësuese ndihmëse në Gurrë të Madhe.

Marrëdhëniet e punës mes ankuses znj.K, në cilësinë e punëmarrësit dhe SHMB Suç, në cilësinë e punëdhënësit rregullohen me ligj të veçantë, ligjin nr.69/2012 “Për Arsimin Parauniversitar” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Referuar udhëzimit nr.38, kreu 8, pika 3 e tij, ndërprerja e marrëdhënieve të punës së mësuesit me institucionin publik të arsimit parauniversitar bëhet:

“...kur jep dorëheqjen,

kur mbush moshën e pensionit,

kur bëhet i paafte për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike ose mendore,

kur dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës,

*kur merret masë disiplinore të largimit nga puna,
kur institucioni shkollor nuk i ofron ngarkesë mësimore lëndore”.*

Për rastin, kur institucioni nuk i ofron ngarkesë mësimore lëndore zbatohen procedurat e parashikuara në kreun 7, pika 1, sipas së cilave mësuesi njoftohet në muajin maj dhe paraqet kërkesë për lëvizje paralele të detyrueshme po në muajin maj në Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve (Komisioni) pranë ZA për të konkuruar për një vend vakant pune. Konkurimi bëhet me dosje dhe vlerësimi bëhet nga Komisioni në muajin gusht.

Në këtë rast, ligji ka parashikuar një afat njoftimi, që është afati prej tre muajsh, nga muaji maj që paraqitet kërkesa deri në muajin gusht që vlerësohet dosja.

Deri në momentin e lëvizjes së detyrueshme paralele të znj.K, me datë 12.10.2017, nuk rezulton të ketë asnjë vendimmarrje nga ana e SHMB Suç, në cilësinë e punëdhënësit për ndërrime të marrëdhënieve të punës me të. Akti i largimit të mësuesit për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore lëndore në shkollë nxirret nga drejtori i shkollës.

Me kërkesën e datës 18.09.2017 SHMB Suç ka vënë në lëvizje Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve duke i kërkuar vlerësimin e dosjeve të kandidatëve të profileve biologji-kimi dhe gjuhë-letërsi.

Komisioneri vëren se, SHMB Suç nuk mund t'i paraqesë kërkesë këtij Komisioni në emër të ankueses dhe as t'i kërkojë atij të vlerësojë dosjen e saj (ky interpretim vlen edhe për mësuesit e tjerë) pasi nuk është kompetencë e drejtuesit të shkollës por e vetë mësuesit të cilit i është komunikuar mbetja pa ngarkesë mësimore lëndore si rezultat i shkurtimit të normës mësimore (si pasojë e shkurtimit të një klase në rastin konkret).

Nga ana tjetër, Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve nuk bën vlerësim të dosjeve të mësuesve të të njëjtit profil në nivel shkolle, por të dosjeve të mësuesve të të njëjtit profil në nivel të njësisë arsimore vendore. Konstatohet se në rastin konkret, Komisioni ka vlerësuar dosjet e tre mësuesve të të njëjtit profil (biologji-kimi), brenda të njëjtit institucion (SHMB Suç) duke përcaktuar kështu se cili mësues do të plotësohet me ngarkesë mësimore dhe cili do të largohet, duke marrë kështu kompetencat e drejtorit të shkollës.

Referuar Udhëzimit nr.38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të mësuesit në Institucionin Publik të Arsimit Parauniversitar” kërkesa për lëvizje paralele të detyrueshme, si dhe lëvizja paralele është në dëshirë të mësuesit dhe nuk vjen si detyrim i ligjit; prandaj Komisioneri vëren se, paraqitja e kërkesës nga drejtori, po ashtu dhe lëvizja e detyrueshme paralele nga ana e ZA Mat, janë bërë në tejkallim të kompetencave që atyre u njihet ligji.

Sa më sipër, nga verifikimi i dosjes së ankueses dhe të mësuesve SH.K dhe A.S nuk rezulton që Komisioni të ketë të regjistruar asnjë kërkesë me shkrim nga ana e tyre për vlerësim të dosjeve.

Komisioni nuk vihet në lëvizje për vlerësimin e dosjeve të mësuesve për largimin e mësuesit nga puna; përkundrazi, Komisioni vihet në lëvizje për të përcaktuar nëpërmjet konkurimit me dosje fituesit për vendin e shpallur vakant.

Kreu 4, pika 8 e po këtij udhëzimi citon se: “Për një vend të lirë pune me ngarkesë të plotë mësimore dhe të përhershme, Komisioni është i detyruar të ftojë në fillim kandidatët për mësues që janë të punësuar në një “vend me ngarkesë të pjesëshme apo të përkohëshme”.

Kjo gjë nuk ka ndodhur me ankuesen, znj.K, edhe pse ajo ka qenë mësuese me emërim të përhershëm në SHMB Suç, me 25 vite punë dhe më titullin mjeshtër, si dhe me “kemp” dhe banim në fashtin Suç.

Paaftësia fizike (apo mendore) për punë, përcaktohet nga KMCAJ-ja²⁰, i cili është organi kompetent që në bazë të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Funkcionimit të KMCAJ-së, bën përcaktimin e shkallës së humbjes së aftësisë për punë. Në këtë logjikë, edhe pse subjekti ankues pretendon diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, Komisioneri vlerëson se shkak është aftësia e kufizuar.

Nisur nga kronologjia e ngjarjeve rezulton se, znj.K ka qenë në marrëdhënie pune me SHMB Suç dhe pavarësisht procedurës së zhvilluar nga shkolla dhe ZA Mat për normimin e orëve të mësuesve në fillim të vitit shkollor 2017-2018, vetë shkolla në cilësinë e punëdhënësit nuk ka nxjerrë vendim për largimin e saj pas mbetjes pa ngarkesë mësimore, gjë që do të shënonte edhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës më të. Nga dokumentacioni i depozituar pranë KMD-së provohet se SHMB Suç, me vendimin nr.03, datë 09.01.2018 ka vendosur përfundimin e marrëdhënieve të punës me znj.M. K si mësuese e profilit biologji-kimi. (rreth 3 muaj pas komunikimit të vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve).

Nga ana tjetër, ZA Mat ka vijuar me marrjen e vendimit për lëvizje paralele të znj.K, në kundërshtim flagrant me parashikimet e ligjit nr.69/2010 “Për Arsimin Parauniversitar” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. ZA Mat do mund të ndërmerre një vendim të tillë, vetëm po të kishte vende vakante të shpallura nga shkollat e tjera, si dhe me kërkesë të mësuesve të interesuar për të konkuruar për këto vende vakante. Sikurse shihet qartë, asnjë nga këto kushte nuk është respektuar nga ana e ZA Mat, pasi:

- Nuk ka patur shpallje të vendit vakant në shkollën 9-vjeçare “Gurrë e Madhe”.
- Nuk ka patur asnjë kërkesë nga znj.M. K.
- Nuk është zhvilluar asnjë konkurim lidhur me këtë gjë.

Për më tepër, theksojmë edhe dy elementë kyç lidhur me lëvizjen e detyrueshme paralele të ankueses:

E para, duke emëruar znj.K si mësuese ndihmëse në shkollën 9-vjeçare “Gurrë”, nuk është vlerësuar dhe as marrë në konsideratë nga ZA Mat interesi më i lartë i nxënësve me aftësi të kufizuar. Duke emëruar një mësuese të profilit biologji-kimi dhe pa asnjë trajnim të veçantë apo njohuri për elementët bazë për të punuar me këtë kategori nxënësish, në kundërshtim të plotë me parashikimet ligjore ZA Mat kishte cënuar të drejtën e këtyre nxënësve për një arsimin sa më cilësor në përputhje me sa parashikon ligji.

Neni 65, i ligjit nr.69/2010 “Për Arsimin Parauniversitar”, në nenin 65, pikën 3 të tij, ka përcaktuar se: “...Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim

²⁰ KMCAJ është shkurtesë për Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë.

rehabilitues, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve". Eshtë pranuar nga ankuesja që nuk ka asnjë lloj trajnimi apo njohurie specifike lidhur me punën me nxënës me aftësi të kufizuara. Po ashtu nuk është provuar e kundërta nga ZA Mat.

E dyta, edhe pse është pranuar nga ZA Mat fakti që znj.K është trajtuar me "Kemp" për paaftësi të pjesshme në punë, ky fakt nuk është mbajtur parasysh në momentin e lëvizjes së detyrueshme paralele të saj në fshatin Gurrë e Madhe, larg vendbanimit të saj, fshatit Suç.

Në analizë të sa më lart, Komisioneri konstaton se ankuesja është ekspozuar ndaj një trajtimi të paligjshëm dhe tendencioz nga ana e SHMB Suç dhe ZA Mat, duke filluar që nga procedura e vlerësimit të dosjeve, lëvizjes së detyrueshme paralele dhe duke vijuar deri në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të.

Ligji nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", në nenin 12 të tij, pika 1, germa b) parashikon se: "Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës".

Neni 13, i po këtij ligji, parashikon masat që punëdhënësi duhet të ndër marrë, duke përcaktuar se: "...Punëdhënësi është i detyruar: të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloj diskriminimi; të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dëgjimit; t'u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre".

Për sa më lart, Komisioneri konstaton se ZA Mat dhe SHMB Suç, jo vetëm nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në ligjin 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", duke mos marrë asnjë masë për të rregulluar situatën, por përkundrazi, e ka përkeqësuar atë deri në largimin përfundimtar të ankueses nga puna.

Lidhur me këtë, Komisioneri vëren se, ankesën pranë KMD-së z.M. K e ka paraqitur me datë 06.11.2017, dhe pasojat rënduese në vijim apo masat e ndërmarra nga ZA Mat dhe SHMB Suç kanë ardhur kryesisht pas kësaj date²¹ dhe kanë ardhur edhe si rezultat i këtij ankimimi.

Ligji 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" ka parashikuar në nenin 3, pika 8 të tij, se: "trajtimi i disfavorshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë është "Viktimizim".

Referuar datës së lirimit të saj nga detyra.²¹ (Me datë 09.01.2018).

Komisioneri vlerëson se ndjekja e rrugëve ligjore për të kërkuar dhe rivendosur një të drejtë të cënuar është e drejtë legjitime e çdokujt.

Komisioneri konstaton se ZA Mat dhe SHMB Suç e kanë diskriminuar ankuesen në formën e viktimizimit, (për shkak se të gjitha pasojat në dëm të ankueses nga ana e këtyre dy institucioneve janë intensifikuar deri në largimin përfundimtar nga puna, pas depozitimit të ankesës së saj pranë KMD-së).

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë *“në gëzimin e të drejtave dhe lirive”* të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.²²

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me...c) kushtet e punës dhe punësimin, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”*.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së²³. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen kundër diskriminimit”*, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10 221/2010 parashikohet se ndalohet

²² https://eëë.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_laë_SQI.pdf, faqet 47 dhe 49

²³ Referuar nenit 3, pika 8 ,e LMD-së.

diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1, të tij.

Për sa më lart, Komisioneri konstaton se ankuesja znj.M. K është trajtuar në mënyrë të paligjshme dhe të pafavorshme dhe se masa e marrë për lëvizjen e detyrueshme paralele dhe më pas largimin e saj nga puna është e qëllimshme, e pajustificuar, jo objektive dhe e pa argumentuar ligjërisht. Kjo bindje përforcohet nga tendenca dhe veprimet arbitrare dhe në shkelje flagrante të ligjit nga ana e SHMB Suç dhe ZA Mat.

B. Lidhur me shkaqet e pretenduara nga ankuesja si shkaqe të sjelljes diskriminuese ndaj saj nga ana e ZA Mat.

- Pretendimi i znj.K se shkak për diskriminim ndaj saj janë bërë gjendja shëndetësore dhe bindjet e saj politike përbëjnë shkaqe që gëzojnë mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.

“Aftësia e kufizuar” dhe “bindjet politike” janë shkaqe, për të cilat Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë nga hetimi, Komisioneri konstaton se subjekti ankues ka provuar se mbart shkaqet e pretenduara.

- a) Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, subjekti ankues ka provuar se ka bindje të djathta politike, pasi:
 - Me vertetimin nr.09 prot., datë 19.02.2018 provohet se znj.K është anëtare e Këshillit Bashkiak Klos, Bashkia Klos si përfaqësuese e subjektit politik “Partia e Bashkimit Demokrat” (LDG Mat).
 - Me vërtetimin nr.02 prot., datë 19.02.2018 provohet se znj.K është sekretare e seksioni Suç të këtij subjekti politik dhe se ajo është aktivizuar në të gjitha aktivitetet politike të këtij seksioni dhe në aktivitetet e përgjithshme të LDG Dega Mat.

Pra, nga sa shihet ankuesja i ka të ekspozuara bindjet e saj politike, të cilat dhe i ka dokumentuar shkresërisht.

Nga ana tjetër, sa i takon provimit të bindjeve politike të drejtuesit të SHMB Suç, në cilësinë e punëdhënësit të subjektit ankues, megjithëse ai e deklaroi veten si person me bindje të djathta dhe anëtar të subjektit politik “Partia Demokratike”, nuk ka sjellë dokument shkresor (vërtetim

nga subjekti politik) që ta provojë atë. Por, theksojmë gjithashtu, se deklarimi i z.D nuk është kundërshtuar nga pala ankuese. Në këtë aspekt, bindjet politike të drejtuesit të SHMB Suç mbeten të karakterit deklarativ dhe të pa mbështetura shkresërisht. Theksojmë faktin se vetë drejtuesi i SHMB Suç është emëruar nga ana e ZA Mat, pavarësisht bindjeve të tij politike. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se nuk kemi trajtim të pafavorshëm të ankueses për shkak të bindjeve të djathta politike, nga ana e ZA Mat, për faktin se edhe drejtuesi i SHMB Suç ka bindje të djathta politike, dhe ky nuk mund të qëndrojë si fakt për të provuar se diskriminimi i znj.K ka ardhur si pasaojë e bindjeve të saj politike.

- b) Po ashtu, referuar vërtetimit nr.221, datë 27.04.2017 të Komisionit të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) Mat, znj.Kuka përcaktohet e aftë për punë, për $\frac{3}{4}$ e normës pedagogjike.

KMCAP-ja është organi kompetent për caktimin e aftësisë për punë të personave që komisionohen pranë tij. **Në rastin konkret, vërtetimi i këtij organi provon pretendimin e ankueses sa i takon gjendjes shëndetësore të saj, në rastin konkret KMCAP-ja është shprehur për aftësi të kufizuar të ankueses.**

C. Lidhja e shkaqeve të provuara nga ankuesja me trajtimin e pafavorshëm të saj.

- A ka qenë ky trajtim objektiv dhe i arsyeshëm nga ana e SHMB Suç dhe ZA Mat?

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e ZA Mat, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”²⁴ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankuesit.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Sa i takon pretendimit për trajtim të pafavorshëm për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesja sikurse citohet më lart në vendim, ka arritur të provojë bazuar në dokumentacion se tajtohet me “kemp”, raport për aftësi të kufizuar.

Nga ana e palëve ndaj së cilës është ankuar znj.K është pranuar ky fakt, që ata ishin në dijeni të gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar të ankueses. (kishin të depozituar në dosjen e saj vërtetimin e KMCAP-së).

“Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr.108, datë 15 Nëntor 2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuar, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një mbrojtje e veçantë edhe përsa i takon të drejtës për punë.

²⁴ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Nga ana e ZA Mat dhe SHMB Suç nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se procedura e ndjekur për vlerësimin e dosjes së saj, transferimit të detyrueshëm dhe emërimit si mësuese ndihmëse apo dhe largimi përfundimtar nga puna kanë ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive. Në këto rrethana, Komisioneri, vlerëson se si shkak për trajtimin e saj të paligjshëm, të pafavorshëm, jo objektiv dhe diskriminues është bërë aftësia e kufizuar e saj.

Po ashtu, në “Kartën Sociale Europiane” të rishikuar²⁵, dhe shtojcën e saj, në nenin 24, pika 3, gërmat d) e f) të tij, parashikohet se: “...d) Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:... d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare, përgjegjësitë familjare, shtatzania, besimi fetar, opinioni politik, prejadhja kombëtare ose origjina sociale. f) mungesa e përkohshme në punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi”.

Referuar barrës së proves sikurse është cituar dhe më lart në vendim, ZA Mat dhe SHMB Suç, si subjekte nga të cilat është pretenduar diskriminimi, duhet të provonin se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe më pak të favorshme, për shkaqet e pretenduara prej saj. Të provosh një çështje diskriminimi është e vështirë, pasi autorët e diskriminimit nuk deklarojnë se ata trajtojnë dikë në mënyrë më pak të favorshme se të tjerët, lidhur me një shkak të caktuar.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës – *praesumptio iuris tantum*.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi (ankuesi) duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “ të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara”.²⁶

Subjekti ankues nga ana tjetër, duhet detyrimisht të provojë ekzistencën e shkakut të pretenduar të diskriminimit, atë të bindjes politike dhe të aftësisë së kufizuar, si shkaqet e vërteta dhe thelbësore të zgjidhjes së kontratës së punës.

Për sa më sipër, Komisioneri gjen të provuar dhe të mbështetur në argumente bindëse dhe në ligj, se aftësia e kufizuar dhe jo bindjet politike të ankuses kanë çuar në trajtimin e pafavorshëm, të padrejtë dhe të paligjshëm të saj, nga ana e ZA Mat.

²⁵ “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

²⁶ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është autoriteti i cili siguron mbrojtje efektive të nenit 18 të Kushtetutës të RSH-së, ku parashikohet parimi i barazisë sipas të cilit të gjithë qytetarët duhet të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm për të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit ardhur për shkak të aftësisë së kufizuar të znj.M. K, nga ana e ZA Mat dhe SHMB Suç.
2. Referuar pikës pikës 2, të vendimit, SHMB Suç, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj znj.M. K²⁷, të bëjë rikthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës, si mësuese e lëndës biologji-kimi në SHMB Suç.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë)ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, SHMB Suç, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(shkaku: aftësia e kufizuar)
(fusha: punësim)

²⁷ Në tagrin e punëdhënësit.